



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 9 mars 2023

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Marrjen në Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave

**Ushtruesit të Detyrës së Prokurorit të
Specializuar**
Aleks Uajting

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 22(3) dhe (6), 40(2) dhe (6)(h) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 2, 113(7), 114(1), (2) dhe (4), dhe 143 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 janar 2023, Trupi Gjykues lëshoi Urdhrin mbi Zhvillimin e Gjykimit.¹
2. Më 3 dhe 13 shkurt 2023, Mbrojtësi i Viktimave njoftoi Trupin Gjykues për synimin e tij që të merrte në pyetje gjithsej tre dëshmitarë² nga lista e dymbëdhjetë dëshmitarëve të parë të Prokurorit të Specializuar ("ZPS").³
3. Më 8 shkurt 2023, Mbrojtja e Hashim Thaçit ("Mbrojtja e Thaçit") i kërkoi Trupit Gjykues ta urdhëronte Mbrojtësin e Viktimave që t'i bënte pyetjet në mënyrë të paanshme dhe t'u shmangej pyetjeve sugjeruese apo me përgjigje të përcaktuara ("Kërkesa").⁴
4. Më 15 shkurt 2023, Trupi Gjykues: (i) urdhëroi Mbrojtësin e Viktimave që brenda orës 16:00 të 22 shkurtit 2023 të dorëzonte parashtrime në lidhje me çfarë lloj pyetjesh përmban "marrja në pyetje" në bazë të paragrafit 76(ii)(a) të Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit, dhe që përgjigjet, nëse do të kishte të tilla, të

¹ F01226, Trupi Gjykues II, *Urdhër mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 25 janar 2023, me shtojcën 1.

² F01253, Mbrojtësi i Viktimave, *Njoftim i Mbrojtësit të Viktimave për Dëshirën për të Pyetur Dëshmitarët dhe Kërkesën për Kohë Shtesë për të Dorëzuar Njoftim Tjetër*, 3 shkurt 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 6 shkurt 2023, F01253/RED); F01285, Mbrojtësi i Viktimave, *Njoftim i Mëtejshëm i Mbrojtësit të Viktimave për Dëshirën për të Pyetur Dëshmitarët (sikurse renditen në F01243)* ("Njoftimi i Mëtejshëm i Mbrojtësit të Viktimave"), 13 shkurt 2023, konfidencial (versioni i redaktuar publik u dorëzua më 22 shkurt 2023, F01285/RED).

³ F01243, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim nga Prokuroria i Listës së 12 Dëshmitarëve të Parë dhe Informacionit Shoqërues*, 1 shkurt 2023, me Shtojcën 1, konfidencial.

⁴ F01267, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Njoftimit të Mbrojtësit të Viktimave për Dëshirën për të Pyetur Dëshmitarët dhe Kërkesën për Kohë Shtesë për të Dorëzuar Njoftim Tjetër*, (F01253), 8 shkurt 2023, konfidenciale, para. 5.

dorëzoheshin më 27 shkurt 2023; dhe (ii) vendosi që nuk do të pranoheshin kundërpërgjigje. (“Urdhri i Gjashtë Gojor”).⁵

5. Më 22 shkurt 2023, Mbrojtësi i Viktimave dorëzoi parashtrimet e tij në bazë të Urdhrit të Gjashtë Gojor (“Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave”).⁶

6. Më 27 shkurt 2023, Mbrojtja e Thaçit dorëzoi parashtrimet e veta në bazë të Urdhrit të Gjashtë Gojor (“Parashtrimet e Thaçit”).⁷

II. PARASHTRIMET

7. Në Kërkesë, Mbrojtja e Thaçit i kërkon Trupit Gjykses të urdhërojë Mbrojtësin e Viktimave që t’i bëjë pyetjet në mënyrë të paanshme dhe t’u shmanget pyetjeve sugjeruese apo me përgjigje të përcaktuara,⁸ në mënyrë që të sigurohet drejtësia e procesit dhe në pajtim me praktikën e tribunalëve të tjerë ndërkombëtarë.⁹ Ajo argumenton se dëshmitarët që dëshiron të “marrë në pyetje” Mbrojtësi i Viktimave nuk janë kundërshtarë të tij, gjë që përjashton çdo arsye që “marrja në pyetje e tyre” të bëhet me pyetje sugjeruese ose me përgjigje të përcaktuara. Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit parashtron se roli i Mbrojtësit të Viktimave ndryshon nga roli i ZPS-së, gjë që duhet pasqyruar edhe në kuadrin dhe llojin e pyetjeve të bëra.¹⁰

8. Mbrojtësi i Viktimave i kërkon Trupit Gjykses të përdorë një qasje elastike, rast pas rasti, në lidhje me të gjitha palët dhe pjesëmarrësit për lejimin apo jo të pyetjeve sugjeruese.¹¹ Ai parashtron se nuk duhet të ketë dallim midis rregullave që ndiqen për përdorimin e pyetjeve sugjeruese nga Mbrojtësi i Viktimave dhe

⁵ Transkripti i Seancës 15 shkurt 2023, f. 2039, rreshti 25 deri në f. 2040, rreshti 5 (Urdhri i Gjashtë Gojor).

⁶ F01314, Mbrojtësi i Viktimave, *Parashtrime të Mbrojtësit të Viktimave mbi Llojin e Pyetjeve Gjatë Marrjes në Pyetje*, 22 shkurt 2023.

⁷ F01326, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Parashtrimeve të Mbrojtësit të Viktimave mbi Llojin e Pyetjeve Gjatë Marrjes në Pyetje*, 27 shkurt 2023.

⁸ Kërkesë, para. 3, 5.

⁹ Kërkesa, para. 3-4.

¹⁰ Kërkesa, para.4.

¹¹ Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave, para. 1, 40.

rregullave që ndiqen me palët e tjera në këtë drejtim.¹² Sipas Mbrojtësit të Viktimave, një dallim i tillë: (i) nuk do ishte i bazuar as në Rregullore, as në Ligj;¹³ (ii) nuk do të pasqyronte praktikën e deritanishme të Dhomave të Specializuara (“DHS”);¹⁴ (iii) nuk do të përputhej me qasjen e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës;¹⁵ (iv) do të ishte i panevojshëm;¹⁶ dhe (v) nuk do të bazohej në ndonjë praktikë të vendosur nga Gjykata Penale Ndërkombëtare (“GJPN”).¹⁷ Gjithashtu, Mbrojtësi i Viktimave argumenton se kriteri që propozon Mbrojtja e Thaçit, dhe që bazohet në të qenit apo jo të dëshmitarit “kundërshtar” me palën pyetëse, është i panevojshëm, i padobishëm dhe i pavolitshëm.¹⁸

9. Në Parashtrimet e Thaçit, Mbrojtja e Thaçit i kërkon Trupit Gjykses të urdhërojë Mbrojtësin e Viktimave që t’i bëjë pyetjet në mënyrë të paanshme dhe t’u shmanget pyetjeve sugjeruese apo me përgjigje të përcaktuara, pa cenuar të drejtën e Mbrojtësit të Viktimave për t’i kërkuar Trupit Gjykses, në bazë të paragrafit 35 të Urdhrit mbi Zhvillimin e Gjykimit, leje për pyetje sugjeruese apo me përgjigje të përcaktuara në qoftë se janë të nevojshme për mbrojtjen e interesave vetjake të viktimave pjesëmarrësve në proces dhe në përpunje me të drejtat e të akuzuarve.¹⁹ Mbrojtja e Thaçit argumenton se Rregullorja ia jep të drejtën e marrjes në pyetje vetëm palëve, jo Mbrojtësit të Viktimave.²⁰ Gjithashtu, ajo argumenton se duke qene se Rregullorja u jep vetëm palëve të drejtën e marrjes në pyetje të dëshmitarëve të një pale kundërshtare për temën e caktuar për marrjen në pyetje prej palës thirrëse dhe për aspekte që ndikojnë në besueshmërinë e dëshmitarëve, si rregull i përgjithshëm, vetëm palët duhen lejuar të bëjnë pyetje

¹² Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave, para. 1, 11.

¹³ Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave, para. 12, 14-18.

¹⁴ Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave, para. 12, 19-21.

¹⁵ Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave, para. 12, 22-23.

¹⁶ Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave, para. 12, 24-29.

¹⁷ Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave, para. 12, 30-34.

¹⁸ Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave, para. 13, 35-39.

¹⁹ Parashtrime të Mbrojtjes së Thaçit, para. 25.

²⁰ Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 1, 11, 13-14, 17.

sugjeruese gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve të palës kundërshtare.²¹ Gjithashtu, Mbrojtja e Thaçit pretendon se parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave sipas të cilave nuk duhet të ketë dallim midis rregullave që ndiqen për përdorimin nga ana e tij e pyetjeve sugjeruese gjatë marrjes në pyetje dhe rregullave që ndiqen nga palët bazohen në: (i) një interpretim të gabuar të Rregullores;²² (ii) në dispozita të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës që janë zëvendësuar nga Rregullorja;²³ dhe (iii) në mosmarrjen parasysh të qëllimit të marrjes në pyetje sipas përcaktimit të Rregullores.²⁴

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Dispozitat përkatëse ligjore shtjellohen konkretisht në rregullat 114(4) dhe 143, siç do të diskutohet më poshtë.

IV. DISKUTIM

A. ÇËSHTJE PARAPRAKE: DORËZIMI I PËRGJIGJEVE NDAJ NJOFTIMEVE; KËRKESA E MJETIT JURIDIK NË PËRGJIGJE APO KUNDËRPËRGJIGJE

11. Paraprakisht, Trupi Gjykses vëren se mjete juridik i kërkuar nga Mbrojtja e Thaçit ishte pjesë e një përgjigjeje ndaj një njoftimi të Mbrojtësit të Viktimave. Njoftimi nuk është mocion që të krijojë mundësi për përgjigje. Rregulla 76 parashikon se radha e parashtrimeve është: mocion; përgjigje; kundërpërgjigje. Me qëllim që të ndiqet si duhet kjo radhë, Trupi Gjykses u kujton palëve dhe pjesëmarrësve që të mos paraqesin përgjigje ndaj njoftimeve dhe në përgjithësi të mos kërkojnë mjete juridike për një pikë të caktuar në një përgjigje apo kundërpërgjigje. Çdo palë apo pjesëmarrës që kërkon mjet juridik për një aspekt

²¹ Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 1, 22.

²² Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 9-15.

²³ Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 9, 16.

²⁴ Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 6, 17-24.

konkret, përgjithësisht duhet të paraqesë një mocion i cili i hap rrugë radhës dhe afateve që përcaktohen në rregullën 76.

12. Megjithatë, me qëllim që kjo çështje të zgjidhet në mënyrë të përsheptuar, Trupi Gjykses do të bëjë përjashtim e do ta trajtojë Kërkesën si parashtrim të vlefshëm.

B. MARRJA NË PYETJE NGA MBROJTËSI I VIKTIMAVE

13. Në zbatim të rregullës 114(4), kurdo që preken interesat personale të viktimave pjesëmarrëse në proces dhe nëse Rregullorja nuk parashikon ndryshe, mbrojtësi i viktimave, nën mbikëqyrjen e trupit gjykses, mund të bëjë parashtrime me gojë dhe me shkrim, dhe t'u bëjë pyetje dëshmitarëve. Nëse është e nevojshme dhe varësisht nga rrethanat, trupi gjykses nxjerr udhëzime të posaçme që rregullojnë pjesëmarrjen e viktimave në proces, në pajtim me nenin 22(3) dhe (6). Mbrojtja e Thaçit vëren²⁵ se rregulla 114(4) "shprehimisht ia le Trupit Gjykses kompetencën të përcaktojë mënyrën se si duhet lejuar Mbrojtësi i Viktimave të marrë dëshmitarët në pyetje.²⁶

14. Në pajtim me rregullën 114(4), dhe pa kundërshtim nga Mbrojtja, Urdhri i Trupit Gjykses mbi Zhvillimin e Gjykimit bënte të qartë se në procesin e tanishëm do të lejohej marrja në pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave .²⁷ Gjithashtu, Trupi Gjykses përcaktoi kufizimet e mëposhtme për llojin e pyetjeve që Mbrojtësi i Viktimave mund t'u bëjë dëshmitarëve:

34. Marrja në pyetje e dëshmitarëve nga Mbrojtësi i Viktimave, parimisht kufizohet te: (i) dëmi ose lëndimi që u është shkaktuar dëshmitarëve dhe rrethanat në të cilat

²⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit, para. 13.

²⁶ *Shih edhe* KSC-BC-2020-05, F00152, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi të Drejtat Procedurale gjatë Gjykimit*, 12 korrik 2021, para. 40, dhe KSC-BC-2020-04, F00433, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi të Drejtat Procedurale të Viktimave gjatë Gjykimit dhe Çështje të Lidhura me To*, 24 shkurt 2023, para. 48, ku Trupi Gjykses I gjykon se rregulla 114(4) nuk përcakton ndonjë kufizim konkret në lidhje me llojin e pyetjeve që mund t'u bëjë Mbrojtësi i Viktimave dëshmitarëve.

²⁷ *Shih* Urdhrin Paraprak mbi Zhvillimin e Gjykimit , para. 33, 76(ii)(a), 109, 131(ii).

ka ndodhur; (ii) pasojat e këtyre veprimeve mbi viktimën, të afërmit e ngushtë ose mbi komunitetin të cilit i përket ai apo ajo; dhe (iii) mjete juridik i përshtatshëm për kompensimin e dëmit shkaktuar viktimës.

35. Nëse Mbrojtësi i Viktimës dëshiron të bëjë pyetje në lidhje me ndonjë temë tjetër, ai duhet t'i kërkojë lejë Trupit Gjykses, shoqëruar me: (i) një paraqitje të shkurtër të temës; dhe (ii) një llogaritje të kohës së nevojshme për pyetje shtesë.

15. Rregulla 143(1) përcakton se pala pyetëse mund t'i bëjë pyetje dëshmitarit dhe t'i tregojë çfarëdo dokumenti apo prove tjetër në përputhje me Rregulloren. Më tej ajo thotë se në qoftë se një dëshmitar nuk mund të kujtojë faktet që ka dhënë në një deklaratë të mëparshme, me leje prej trupit gjykses, dëshmitarit mund t'i tregohen dokumente për t'i freskuar kujtesën. Më pas, fjalia e fundit e rregullës 143(1) përcakton se: "Ky paragraf zbatohet *mutatis mutandis* kur mbrojtësi i viktimave u bën pyetje dëshmitarëve."

16. Rregulla 143(3) trajton posaçërisht marrjen në pyetje nga pala kundërshtare: "Pyetjet nga pala kundërshtare përqendrohen vetëm në temën e pyetjeve të palës thirrëse dhe në aspekte që ndikojnë në besueshmërinë e dëshmitarit. Në rast se dëshmitari është në gjendje të japë dëshmi që ka lidhje me argumentin e palës kundërshtare, dëshmitari mund të pyetet në lidhje me atë temë, me kusht që pala përkatëse t'i shpjegojë dëshmitarit llojin e argumentit."

17. Në këtë dispozitë me marrjen në pyetje nënkuptohen pyetjet që bëhen nga një përfaqësues ligjor që nuk është palë thirrëse. Lidhur me këtë Trupi Gjykses gjykon se rregulla 143(3) nuk përjashton pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave kur merret në pyetje një dëshmitar i thirrur nga ZPS-ja ose nga Mbrojtja. Trupi Gjykses nuk mendon se përmendja e "palës kundërshtare" në fjalinë e dytë të rregullës 143(3) ndikon mbi këtë përfundim. Kjo fjali thjesht përcakton në terma të përgjithshme kuadrin e pyetjeve të lejueshme nga një përfaqësues ligjor që nuk është palë thirrëse.

18. Në bazë të rregullës 143(4), kryegjykatësi ka kompetencë të gjerë diskrecionale që të ushtrojë kontroll mbi mënyrën dhe rendin e marrjes në pyetje të

dëshmitarëve dhe paraqitjen e provave me qëllim që, ndër të tjera: “të arrihet që pyetjet dhe paraqitja e provave të jenë të efektshme në përcaktimin e të vërtetës” dhe “të shmangen përsëritjet (dhe) harxhimi i panevojshëm i kohës dhe i mjeteve”. Kompetenca e Kryegjykatësit për të kontrolluar në këtë mënyrë marrjen në pyetje përfshin pyetjet nga pala thirrëse, ato të palës kundërshtare dhe pyetje shtesë, si edhe pyetje nga çdo palë apo pjesëmarrës. As rregulla 114(4), as rregulla 143, as ndonjë dispozitë tjetër nuk i ndalojnë shprehimisht pyetjet sugjeruese, as nuk kufizojnë mënyrën si duhen bërë pyetjet.

19. Trupi Gjykes i kthehet tani jurisprudencës së GJPN-së që përmendet nga Mbrojtësi i Viktimave dhe Mbrojtja e Thaçit.²⁸ Kjo jurisprudencë arrin në përfundime të ndryshme mbi temën nëse Mbrojtësi i Viktimave mund të bëjë apo jo pyetje sugjeruese. Ajo mbështet interpretimin e Trupit Gjykes se, në bazë të rregullës 143, mënyra e pyetjes së dëshmitarëve nga Mbrojtësi i Viktimave është kryesisht brenda kompetencës diskrecionale të trupit gjykes përkatës. Trupi Gjykes sjell veçanërisht në vëmendje konkluzionin e Dhomës Gjyqësore *Katanga and Ngudjolo* të përmendur, ndonëse jo në tërësi, nga Mbrojtja. Në të, Dhoma arrin në përfundimin se, në parim, pyetjet nga Mbrojtësi i Viktimës duhen bërë “në mënyrë të paanshme dhe duke iu shmangur pyetjeve sugjeruese ose të përcaktuara”, ndërkohë që e moderon këtë për rrethana në të cilat mbrojtësi vë në dyshim besueshmërinë, saktësinë dhe mbështetshmërinë e dëshmisë së një dëshmitari, në të cilat lejohen pyetje sugjeruese/me përgjigje të përcaktuar.²⁹

20. Duke iu kthyer praktikës së DHS-së, Trupi Gjykes vë në dukje se Trupi Gjykes I, në ushtrim të kompetencës së vet diskrecionale, konstatoi se: (i) në parim, palët dhe Mbrojtësi i Viktimës duhet t’i pyesin dëshmitarët në mënyrë të

²⁸ *Shih* Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave, para. 30-34; Parashtrimet e Thaçit, para. 18-19. *Shih edhe* Kërkesën, para. 4.

²⁹ ICC, *Prosecutor v. Katanga and Ngudjolo Chui*, ICC-01/04-01/07-1665-Corr, Trial Chamber, [Directions for the Conduct of the Proceedings and Testimony in Accordance with Rule 140 \(Corrigendum\)](#), 1 December 2009 (data e origjinalit: 20 nëntor 2009), para. 91.

paanshme; dhe (ii) pyetjet sugjeruese dhe me përgjigje të përcaktuar mund të jenë të lejueshme vetëm kur ato çojnë në përshpejtimin e procesit dhe në përcaktimin e të vërtetës, nën kontrollin e kryegjykatësit në bazë të rregullës 143(4).³⁰ Si rrjedhojë, në lidhje me pyetjet sugjeruese dhe me përgjigje të përcaktuar, Trupi Gjykses I nuk bëri dallim midis palëve dhe pjesëmarrësve.

21. Nga sa më sipër është e qartë se mënyra e marrjes në pyetje nga ana e Mbrojtësit të Viktimave, është në përputhje me Rregulloren dhe praktikën e këtij juridiksioni apo të tjerëve, është aspekt që i përket kompetencës diskrecionale të Trupit Gjykses. Gjithashtu, Trupi Gjykses konstaton se në përgjithësi Mbrojtjes së Viktimave nuk i janë ndaluar pyetjet sugjeruese, veçanërisht në rrethana si ato që përvijohen në precedentin e GJPN *Katanga and Ngudjolo* dhe në precedentët e DHS-së që përmenden më lart.³¹

22. Trupi Gjykses dhe Kryegjykatësi, në zbatim të rregullave 114(4) dhe 143, dhe udhëzimeve që jep Trupi Gjykses në paragrafët 33-35 të Urdhrit për Zhvillimin e Gjykimit, do të mbikëqyrin të gjithë marrjen në pyetje të dëshmitarëve nga Mbrojtësi i Viktimave dhe, sipas nevojës, do të ndërhyjnë rast pas rasti. Trupi Gjykses gjykon se këto dispozita janë të mjaftueshme për të siguruar që pjesëmarrja e Mbrojtësit të Viktimave të mos shkaktojë padrejtësi dhe të jetë në përputhje me të drejtat e të akuzuarve.³²

23. Gjithashtu, Trupi Gjykses vëren se deri tani Mbrojtësi i Viktimave është treguar i përmbajtur në lidhje me numrin e viktimave që dëshiron të pyesë dhe kohën që ka llogaritur për pyetje.³³ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses është bindur se

³⁰ KSC-BC-2020-05, F00170, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 26 gusht 2021, para. 29; KSC-BC-2020-04, F00434/RED, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 24 shkurt 2023, para. 41.

³¹ *Shih* edhe Parashtrimet e Thaçit, para. 12, që i referohet Garner, B. (ed.), *Black's Law Dictionary* (Eighth Edition), Thompson 2004, që thotë se "normalisht pyetësi lejohet të bëjë pyetje sugjeruese [...]".

³² *Shih* nenin 22(6).

³³ *Shih* Njoftimin e Mëtejshëm të Mbrojtësit të Viktimave, para. 10.

koha për pyetje që propozon Mbrojtësi i Viktimave në këtë fazë nuk cenon zhvillimin e efektshëm të gjykimit.

24. Për këto arsye, Trupi Gjykses është bindur se ka kompetencë t'i lejojë Mbrojtësit të Viktimave t'u bëjë pyetje josugjeruese dhe sugjeruese dëshmitarëve të ZPS-së, ose atyre të Mbrojtjes. Trupi Gjykses e lejon Mbrojtësin e Viktimave ta bëjë një gjë të tillë duke qenë i vëmendshëm në ushtrimin e kontrollit të vet në bazë të rregullave 114(4) dhe 143(4) për të garantuar që mënyra e marrjes në pyetje nga ana e Mbrojtësit të Viktimave të mos ketë mungesë paanësie ndaj të akuzuarve. Në përgjithësi Trupi Gjykses parapëlqen të dëgjojë dëshmitë e drejtpërdrejta gojore të dëshmitarëve sipas fjalëve të vetë dëshmitarëve dhe jo sipas formulimit të mbrojtësve, ndonëse pyetjet sugjeruese mund të jenë të pranueshme në rrethana si ato që përvijohen në precedentin e GJPN-së *Katanga and Ngudjolo* dhe në precedentët e DHS-së të përmendur më lart.³⁴

C. KLASIFIKIMI

25. Duke parë se Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave dhe Parashtrimet e Thaçit janë klasifikuar si publike, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen e Thaçit të dorëzojë një version publik të redaktuar të Kërkesës deri më 17 mars 2023. Mbrojtja e Thaçit urdhërohet të redaktojë konkretisht pseudonimin e dëshmitarit që është redaktuar në parashtrimet e protokolluara F01253/RED dhe F01285/RED të Mbrojtësit të Viktimave.

³⁴ *Shih më sipër*, para. 19-20.

V. VENDIM

26. Për këto arsye, Trupi Gjykses:

(a) **RRËZON** Kërkesën; dhe

(b) **URDHËRON** Mbrojtjen e Thaçit të dorëzojë një version publik të redaktuar të Kërkesës deri të **premtën, 17 mars 2023** në bazë të paragrafit 25 të këtij vendimi.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith III

Kryegjykatës

E enjte, 9 mars 2023

Në Hagë, Holandë.